




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dip. <u>2-0/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-4201/13</u>
Nr. I faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>06.12.2013</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.12.2013, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-3262/13, për z. Refki Krasniqi – ish Drejtor i Drejtorisë së Financave në Komunën e Klinës, për arsye se i njëjti tashmë nuk e ushtron funksionin e zyrtarit të lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-3262/13, për zyrtarin e lartë z. Refki Krasniqi – ish Drejtor i Drejtorisë së Financave në Komunën e Klinës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat “Timi” Kosova Sh.p.k., është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Fillimisht, z. Krasniqi është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Në këtë takim ai ka deklaruar se nuk e ushtron më funksionin e zyrtarit të lartë, përkatësisht Drejtorit të Drejtorisë për Financa në Komunën e Klinës.

Pas kësaj, Komuna e Klinës, me kërkesën e Agjencisë, ka dërguar informacionin zyrtar në të cilën vërtetohet se z. Krasniqi nuk e ushtron më këtë funksion.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatohet se është shmangur situata e mundshme të konfliktit të interesit.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

